

Gra që duhen ndjekur në procesin e Vendimmarrjes

Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje ka krijuar një portal për të promovuar leadershipin e grave në politikë dhe në shërbimet sociale.


Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED) ka krijuar portalin e parë online në Shqipëri që ka për qëllim (1) të rrisë ndërgjegjësimin për pjesëmarrjen e grave në procesin e vendimmarrjes, (2) t'u ofrojë informacion përdoruesve mbi zgjedhjet dhe fushatën zgjedhore dhe (3) të lehtësojë marrëdhënien midis grave drejtuese dhe votuesve. Portali është dizenuar në kuadër të nismës "Nxitja e Pjesëmarrjes politike të grave në një vit elektoral"

Vizibiliteti i grave në media është një çështje globale dhe një shqetësim në Shqipëri. Në veçanti, mbulimi mediatik i grave në lidhje me çështjet gjinore po provokon një ripërforsim të stereotipeve gjinore kulturore të rolit të grave dhe duke i penguar ato për të marrë pjesë në politikë.

Monitorimi i medias nga OSCE/ODIHR në Shqipëri thekson që grave kandidatë iu është dhënë mbulim mediatik marginal gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, duke reflektuar çështje të vazhdueshme me pjesëmarrjen e grave në jetën politike. Grave kandidatë iu kushtua vetëm 1 - 5% në monitorimin e stacioneve televizive. TVSH u kushtoi vetëm 4% të lajmeve për gratë kandidatë.

Bazuar në rritjen e përdorimit të TIK dhe duke parë diskriminimin

Nxitja e Pjesëmarrjes Politike të Grave në një Vit Elektoral



tradicional në Shqipëri, Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje ka krijuar një mjet komunikimi më të drejtpërdrejtë dhe ndërveprues që u jep mundësinë grave lider të forcojnë pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse.

Grave kandidatë u kushtohet vetëm 1-5% sipas monitorimit të stacioneve televizive

Portali i krijuar në kuadër të Programit intensiv Trajnues për kandidatët ishte i fokusuar në dhënien e aftësive komunikuese për brandin politik nëpërmjet TIK. Portali përfshin *informacion* për votuesit, partitë politike dhe kandidatët, *profilet* e grave në politikë dhe në shërbimet publike dhe një seksion i veçantë për *gratë që garojnë në zgjedhje*. Qëllimi i këtij portal është të shndërrohet në një mjet në dispozicion të grave lider në politikë dhe në shërbimet publike për t'u lidhur drejtpërdrejtë me votuesit e tyre dhe me komunitetet gjatë fushatës zgjedhore.

Portali është i hapur për të gjitha gratë lider në politikë dhe në shërbimet publike që dëshirojnë të fuqizohen nëpërmjet TIK.

Gjeni një grua në politikë: www.platformmagjinore.al/gra-ne-politike/

Për të aplikuar për të qenë pjesë e platformës: barazinevendimmarrje@gmail.com

Publikimi i Manualit mbi Raportimin e Ndjeshëm Gjinator

Manuali i parë mbi raportimin e ndjeshëm gjinator në Shqipëri është përgatitur për të zgjeruar informacionin midis gazetarëve rreth rëndësisë të raportimit të drejtë dhe përgjegjësisë së balancës gjinore në media.

Tiranë, Gusht 2015- Rrjeti Barazi në Vendimmarrje me mbështetjen e USAID nëpërmjet Assist Impact ka publikuar manualin e parë mbi raportimin e ndjeshëm gjinator për gazetarët në Shqipëri. Ky manual është pjesë e nismës “Zëri i Gruas në Media” që ka për qëllim të rrisë vizibilitetin e grave në politikë dhe kontributin e tyre në diskursin publik nëpërmjet medias.

Media shqiptare karakterizohet nga keqprezantimi i grave në shoqëri. Pasojat e një raportimi të padrejtë janë serioze dhe gratë dhe pikëpamjet e tyre mbi ccështje me interes të përbashkët janë më të pakta se sa të burrave. Burrat dhe gratë janë më të pranishëm në role tradicionale, me gra që përfaqësohen si objekte të kujdesit, si viktimat të ose të targetuara si konsumatore. Më tej studimi “Gratë në vendimmarrje: roli i medias së re së re për një rritje të pjesëmarrjes politike” nënvizon që gratë prezantohen ndryshe, në kuptimin (në mënyrë më negative) se sa burrat dhe janë

më pak të dukshme (në krahasim me numrat e tyre aktual) se sa ata. Në vazhdimësi të këtij studimi theksoi që media duke targetuar gratë dhe vajzat nuk përqendrohet në çështje politike duke provokuar një


Media duke targetuar gratë dhe vajzat shmanë fokusin në çështjet politike duke provokuar një përforcim të stereotipeve gjinore kulturore

përforcim të stereotipave gjinore kulturore të rolit të grave dhe duke i penguar në angazhimin e tyre në politikë.

Bazuar në këto të dhëna, Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje ka përgatitur një manual gjithëpërfshirës edukativ për raportimin e ndjeshëm gjinator në bashkëpunim me Valbona Sulçen dhe me mbështetjen e Edlira Çepanit, Raquel Hernandez Peña dhe Geldona Metaj. Manuali i është ndarë në dy seksione:

1. Pjesa e parë synon të rrisë ndërgjegjësimin për rolin e mediave për barazinë gjinore. Duke përfshirë informacion mbi keqprezantimi i grave në media përcakton portretizimin e grave në shoqëri dhe si pasojë, pjesëmarrjen e grave. Nëpërmjet një analize të plotë, autori u paraqet gazetarëve nevojën e integritetit gjinator në media.

2. Pjesa e dytë përfshin informacion praktik mbi raportimin e ndjeshëm gjinator shoqëruar me shembuj dhe



ushtrime. Autorët përdorin burime, imazhe, gjuhën në manual për t'u paraqitur gazetarëve se si media mund të ndërgjegjësohet për raportimin gjinator.

Në pjesën e fundit të manualit janë përfshirë tri anekse: (1) kuadri ligjor mbi median dhe ccështjet gjinore, (2) check list për të identifikuar raportimin e ndjeshëm gjinator dhe (3) Treguesit e Ndjeshëm Gjinator për Median (TNGjM) nga UNESCO kategoria B: portretizimi gjinator në përmbytjen mediatike.

Arritja e cilësisë bazohet në nocionin që të drejtat dhe mundësitë nuk mbështeten mbi gjininë, por në aftësitë e cdo individi. Qëllimi është që nëpërmjet zbatimit të këtij manuali një kulturë gjinore sensitive do të zhvillohet me tej me mbështetjen e Medias.

Shkarkoni këtu manualin: www.platformagjinore.al/eng/wp-content/uploads/2015/07/Ku-jane-grate-ne-Media.pdf

Baza e të dhënave online e grave profesioniste



Kreu

Rreth Nesh

Statistika

Publikime

Media

Iniciativa

Kontributi Yt

Kjo hapësirë është krijuar në kuadër të nismës "Zëri i Gruas në Media", mbështetur nga USAID nëpërmjet Assist Impact dhe realizohet nga Rrjeti i Grave Barazi në Vendimarrje. Gratë Eksperte është databaza e parë online në Shqipëri që ka për qëllim të promovojë gratë në fusha të ndryshme të ekspertizës dhe t'i lidhë ato me institucionet publike, OJF-të, gazetarët, producentët dhe grupet e tjera të medias, të cilët po kërkojnë për të ftuar dhe burime.

Gratë Eksperte



Elisa Toshkallari
Art. Menaxhim Projekti, Psikologji,
Shkenca Sociale



Elviona Xhyheri
Administratë Publike, Drejtësi



Stela Mecaj
Administratë Publike, Drejtësi,
Edukim



Inida Barjani
Administratë Publike, Edukim,
Gratë në Politikë



Nertila Liacaj
Drejtësi, Të drejtat e njeriut



Fatbardha Amzaj
Edukim

KERKO SIPAS EMRIT

Emri

KERKIM I AVANCUAR

Fjala kyçe:

Rrethi:

Ekspertiza:

SHFLETO SIPAS ALFABETIT

A B C D Dh E F G Gj H I J K L M N
Nj O P Q R Rr S Sh T Th U V X Xh Y
Z Zh Té gjitha

Ky seksion i Website u mundësua nga mbështetja e USAID



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Informacioni që jepet në këtë faqe interneti, nuk është informacion zyrtar i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe nuk përfaqëson opinionet ose pikëpamjet e Agjencisë së

AssistIMPACT

Projekti "Raising Women Voices through Media" financohet nga USAID nëpërmjet Assist Impact.

Rrjeti i Grave Barazi në Vendimarrje ka publikuar bazën e parë të të dhënave të grave eksperte në Shqipëri që ka si qëllim promovimin e më shumë grave në Media.

Tiranë, Korrik 2015- Rrjeti i Grave Barazi në Vendimarrje me mbështetjen e USAID nëpërmjet Assist Impact ka publikuar bazën e vetme online të të dhënave për gratë eksperte në Shqipëri. Kjo bazë online e të dhënave është krijuar në kuadër të nismës "Zëri i Gruas në Media". Baza e të dhënave online e grave eksperte ka si qëllim të promovojë gruan në fusha të ndryshme të ekspertizës dhe t'i lidhë ato me institucionet publike, OJF-të, gazetarët, producentët dhe grupe të tjera mediatike që po kërkojnë për të ftuar dhe për burime.

Bazuar në punën e përditshme dhe kërkimet të Rrjetit të Grave Barazi në Vendimarrje, gratë profesioniste në Shqipëri kanë vështirësi për të qenë të pranishme në media. Gratë zakonisht janë të portretizuara në kategorinë e njerëzve të mesëm, në kontrast me burrat, që vazhdojnë të mbizotërojnë kategorinë e ekspertëve. Më tej, disa përfaqësues të medias janë shprehur që "nuk ka gra eksperte" dhe nëse ka gra eksperte "ato nuk janë mjaftueshëm karizmatike për median". Si rrjedhojë, Rrjeti i Grave Barazi në Vendimarrje ka krijuar bazën unike të të dhënave të grave profesioniste me qëllim përfshirjen e vizibilitetit të grave në media, të risë mundësitë e grave për të qenë të pranishme në media si të ftuara ose si burime dhe për të ndryshuar bashkëbisedimin e medias rreth grave.

Baza e të dhënave të Grave Eksperte përmban 60 profile të grave nga rrethi i Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës

Baza e të dhënave të grave eksperte përfshin 60 profile të grave nga rrethi i Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës, të cilat kanë qenë pjesëmarrëse gjatë trajnimit mbi aksesin dhe pjesëmarrjen në media si pjesë e nismës "Zëri i Gruas në Media" me mbështetjen e USAID nëpërmjet Assist Impact. Gratë eksperte të përfshira në bazën e të dhënave nga fusha të ndryshme të ekspertizës, duke përfshirë: shëndetësinë, biznesin, politikën e jashtme, korrupsionin, politikën e mbrojtjes dhe të sigurisë, edukimin, teknologjinë dhe inovacionin, të drejtat e njeriut, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe të tjera. Secila nga profilet e grave përfshin informacion mbi fushën e tyre të ekspertizës, një përshkrim të shkurtër të jetëshkrimit të tyre, një referencë të shkurtër të përvosjes së tyre në media, si dhe një hapësirë kushtuar artikujve dhe publikimeve të tyre.

Baza e të dhënave është e hapur për këdo grua eksperte që dëshiron të shfaqet në television ose në radio ose të jetë e pranishme në shtypin e shkruar ose në median online.

Kërkoni për një eksperte:

www.platformagjinore.al/eng/experts/

Për të apikuar për të qenë pjesë e bazës së të dhënave të Grave eksperte: barazinevendimarrje@gmail.com

Më shumë gra profesioniste në media



Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje me mbështetjen e USAID nëpërmjet Assist Impact ka zhvilluar tri trajnime me 60 gra profesioniste mbi aksesin dhe pjesëmarrjen në Media në rrethin e Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës në kuadër të nismës “Zëri i Gruas në Media”

Mungesa e integritimit gjinor në media po ndikon në përmirësimin e çështjeve gjinore dhe pjesëmarrjes politike të grave në Shqipëri. Përfshirja e ulët e grave në sferën publike nuk po ndikon vetëm në vizibilitetin e grave por gjithashtu përforcon stereotipet kulturore gjinore në rolin e grave dhe parandalon ato të përfshihen në shoqëri, sidomos në politikë. Në mënyrë që të promovohet më shumë gruaja në media dhe të rrisë pjesëmarrjen e tyre, Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje ka zhvilluar 3 trajnime që u japin aftësitë dhe mjetet e nevojshme të jenë të ftuara ose burime në Media.

Trajnimet e zhvilluara nga Edlira Cepani kanë si qëllim të japin këshilla dhe rekomandime rreth pjesëmarrjes në media si: e folura publike, vetbesimi, teknika se si të arrihet shfaqja mediatike, si të ndahen njohiritë dhe të paraqiten çështje për publikun e gjerë dhe të nxiten diskutimi. Trajnimi përfshiu: (1) Grate dhe Media, (2) Strategjitë e aksesit në Media, (3) Profili

Mediatik dhe (4) Praktika nëpërmjet regjistrimit me video dhe analiza e tyre.

Gjatë trajnimit grate profesioniste ndanë mendimet e tyre rreth çështjeve gjinore në Media. Albina Nuredini (inspektore pranë DAR dhe pjesëmarrëse në trajnim) theksoi: “Përqindja e grave që punojnë në institucionet publike është më e lartë se sa e burrave. Sidoqoftë, gjatë debateve televizive për reformen arsimore grate nuk janë të ftuara. Mendohet që grate nuk janë aq sa duhet profesioniste dhe të zgjuara për të folur për çështje të rëndësishme”.

“...Mendohet që grate nuk janë aq sa duhet profesioniste dhe të zgjuara për të folur për çështje të rëndësishme” Albina Nuredini

Si pjesë të trajnimit, Edlira Cepani përgatiti një ushtrim praktik gjatë të cilit grate eksperte u nxitën të përgatisnin mbulime të ndryshme mediatike: intervista, debate dhe deklarata publike. Pas regjistrimit në video, grate qenë në gjendje të analizojnë gjuhën e përdorur, gjuhën trupore, mesazhin dhe tonin dhe të jepnin disa rekomandime. Në përfundim të trajnimit, grate profesioniste qenë në gjendje të kuptonin më mirë mjedisin aktual mediatik dhe të zhvillonin aftësi për të pozicionuar vetveten si folëse mediatike në fushën e tyre. Trajnimi për grate profesioniste mbi aksesin në media dhe pjesëmarrjen e tyre u paraqiti atyre mënyrat se si ato duhet të sfidojnë median që mesazhet e tyre të dëgjojnë.

